

Zhuljeta Daja¹**Arsimi në Shqipëri në Periudhën 1912-1939, si e Drejtë dhe Detyrim***Received: 5 June 2024 / Accepted: 8 June 2024 / Published: 1 August 2024*

© 2023 Zhuljeta Daja

*Doi: 10.5281/zenodo.13151263***Abstrakt**

Arsimi është baza dhe themeli i personalitetit të individit dhe si i tillë ai duhet t'i shërbejë atij për qëllime avancimi dhe përmirësimi, duke e përgatitur individin për një të ardhme të panjohur, kështu duke e bërë një person të pajisur me njohuri, me qëllim që t'i përshtatet me lehtësi shoqërisë e cila është gjithnjë në ndryshim e sipër. Arsimit nga ana tjetër si një nga të drejtat themelore të njeriut, është një nga elementet bazë për t'i dhënë mundësi që të bëjë më të mirën me jetën e tij. Nëpërmjet këtij artikulli synojmë të japim evoluimin e arsimit në Shqipëri nga Shpallja e Pavarësisë deri në pushtimin fashist 1939. Arsimi në Shqipëri përgjatë periudhës 1912-1939 ka pasur problematika, të cilat ishin pasojë e zhvillimeve ekonomike dhe politike të vendit. Kjo është një nga periudhat e rëndësishme në historinë e arsimit shqiptar. Megjithatë falë atdhedashurisë dhe punës së palodhur të intelektualëve pati arritje të mëdha. E rëndësishme është se në këtë periudhë arsimit u bë pjesë e së drejtës legjitime të njeriut dhe për këtë mjafton të shohim legjislacionin në fuqi, i cili filloi të bënte pjesë të tij këtë të drejtë. Në këtë kontekst u bënë përpjekje të shumta për hapjen e shkollave, hartimin e programeve të reja, dhe mbi të gjitha për mësimin në gjuhën shqipe, të cilat çuan në zhvillime cilësore të së drejtës për arsimim. Për të shkruar artikullin jemi mbështetur në literaturë historiografike dhe në dokumente arkivore. Në përfundim mund të pohojmë se shteti dhe shoqëria bëri përpjekje për arsimimin e shoqërisë, duke e vlerësuar si të drejtë dhe detyrim për qytetarët e saj. Sigurisht, mund të mos ishin të mjaftueshme, por gjithsesi hodhën bazat e arsimit dhe arsimit në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *Arsimim, Legjislacion, Shqipëri, Shkollë, 1912-1939*

¹ Assoc. Prof. Dr. Zhuljeta Kadilli Daja, University College "Beder", Albania, Email: zhkadilli@yahoo.com.

Hyrje

E drejta për arsim është një nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut sepse shërben si përforcuese e të drejtave të tjera kur është e garantuar dhe si përjashtuese për gëzimin e tyre, në rast se mohohet (Tomasevski 2003,1).

Nëpërmjet arsimimit individët kapërcejnë disnivelet e skajshme ekonomike dhe përgatiten për të marrë pjesë në mënyrë të plotë në komunitetin e tyre. Rëndësia e kësaj së drejte është e pamohueshme, jo vetëm pasi është një nga të drejtat themelore të njeriut, por mbi të gjitha pasi ka karakteristikat e një të drejte instrument, nëpërmjet të cilës realizohen të drejtat e tjera të njeriut. Ajo është një nga të drejtat bazë sepse luan një rol të rëndësishëm në përparimin dhe zhvillimin e njerëzve dhe të vetë shtetit. Arsimimi ka një ndikim thelbësor në aftësitë dhe potencialet e individëve dhe komuniteteve për të arritur zhvillimin, si dhe suksesin social dhe ekonomik. Arsimimi siguron njerëzit me njohuri dhe informacion, si dhe kontribuon në ndërtimin e ndjenjës së vetëvlerësimit dhe vetëbesimit dhe drejt realizimit të potencialit të çdo individit. E drejta për arsim është artikuluar në mënyrë të qartë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe më pas përpunuar në Konventën kundër Diskriminimit në Arsim, në Paktin Ndërkombëtar “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” dhe në traktate të tjera ndërkombëtare dhe rajonale. Akti i shteteve nëpërmjet të cilit shprehin angazhimin në nivel ndërkombëtar për respektimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtës së edukimit, gjeneron pritshmëri për realizimin e saj në nivel kombëtar (Mico 2019, 24). Shtetet duhet të marrin masa normative për të promovuar edukimin, të shoqëruara këto nga masa ekonomike dhe sociale për të lejuar fëmijët dhe të rinjtë të përfundojnë arsimimin.

Cili është roli i shtetit në këtë mision? Çfarë duhet të marrë përsipër shteti për të bërë të mundur përhapjen e arsimit cilësor, pa diskriminim, të pranueshëm dhe të mundshëm për përshtatje, për të gjithë? Shteti duhet të luajë rolin kryesor për reforma ligjore dhe institucionale, deri në realizimin e objektivit për të shpërndarë edukim për të gjithë individët, pasi arsimimi ka një rol të pazëvendësueshëm në jetën e qenieve njerëzore. E drejta për arsim funksionon si shumëzues, apo përforcues për gjitha të drejtat e tjera të njeriut kur garantohen dhe përjashton gëzimin e shumicës, kur i mohohet.

Në vëndin tona ka disa periudha kur kjo e drejtë vlerësohet dhe merren masa nga ana e shtetit për të përfshirë të gjithë fëmijët për t’u arsimuar. Për herë të parë e shohim të ligjëruar këtë të drejtë në vitin 1920, në Kongresin e Lushnjës. Gjithsesi, edhe pse nuk e kemi të përfshirë në legjislacion, përpjekjet e patriotëve janë të shumta për hapjen e shkollave shqipe e futjen e

fëmijëve në to. Këto përpjekje janë më të mëdha pas Shpalljes së Pavarësisë e në vazhdim. Qëllimi i studimit është të evidentojë funksionimin e së drejtës për arsimim në Shqipëri, gjë që duket jo vetëm në numrin e shkollave por dhe në rritjen e përgjegjesisë së shtetit për këtë të drejtë të shtetasve të saj. Në vendin tonë gjatë sundimit osman nuk mund të flitej për të drejtë arsimimi. Arsimiti shihej në kontekstin e përhapjes së gjuhës shqipe dhe ruajtjes së identitetit kombëtar. Ky artikull për të arritur qëllimin, analizon problematika, që kanë të bëjnë me zhvillimin e së drejtës për arsimim në aspektin ndërkombëtar, evoluimin e kësaj të drejte në Shqipëri dhe kufizimet në kohë që ajo ka patur. Edhe pse në legjislacionin shqiptar është shfaqur vonë e drejta për arsimim, në fakt ajo ka ekzistuar në shpirtin e shqiptarëve. Motivet kanë qenë politike dhe shoqërore.

1. Sfondi teorik

Tema e trajtuar i përket fushës së historisë, në kontekstin e legjislacionit. Artikulli titullohet: “Arsimimi në Shqipëri në periudhën 1912-1939, si e drejtë dhe detyrim”. Arsimi si e drejtë për shqiptarët është future von në legjislacion. Kjo është surprizuese duke patur parasysh rëndësinë që mbart kjo e drejtë për zhvillimin e qenieve njerëzore (Volio,1979,19). Sipas Fernando Volios, është kjo e drejtë e cila thirret në marrëdhëniet e njeriut me shtetin dhe që i përket çdo qenieje njerëzore, por në kontradiktë me rëndësinë që mbart, u përfshi vonë në marrëdhëniet e shtetit dhe të drejtat e njeriut dhe përcaktimin e karakteristikave që gëzon në kohët tona. Në Shqipëri, për herë të parë, çështja e rëndësishme e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, është prekur në veprën e shkruar nga Sami Frashëri “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është dhe ç’do të bëhet”, botuar në Bukuresht në vitin 1899. Pas këtij momenti e deri në vitin 1939 ka pasur ngjarje në të cilat është trajtuar e drejta e arsimimit të shqiptarëve. Ajo ka qenë e kufizuar, por megjithatë në kohën kur funksionoi kjo e drejtë luajti rol të madh për arsimimin e shqiptarëve.

2. Formulimi i problemeve dhe qëllimeve të punimit

E drejta për arsim në pikëpamje kushtetuese e ligjore në Shqipëri ka qenë e vonë. Në artikull synojmë të paraqesim si ka evoluar kjo e drejtë. Gjithashtu, edhe pse nuk ka qenë e pranuar ligjërisht dëshira dhe përpjekjet për arsim të popullit shqiptar kanë qenë të mëdha, sidomos që nga Rilindja Kombëtare deri në 1939.

3. Pyetjet dhe hipoteza

Pyetja që të vjen menjëherë në mendje është, çfarë kanë bërë shqiptarët për arsimin e tyre? Si ka ecur e drejta për arsimin e popullit shqiptar. A e ka parë si detyrim të tij shteti në periudhën që shkruajmë? A është vlerësuar si e drejtë dhe detyrim për qytetarët? Pse nuk është vlerësuar drejt në këtë periudhë? Përgjigjja e parë që më vjen ndërmend lidhet me pushtimet e njëpasnjëshme të shqipërisë dhe gjendjen ekonomik e sociale të Shqipërisë. Nga konsultimet me literaturën rezulton se arsimit si e drejtë ka ecur më ngadalë në raport me të drejtat e tjera tek shqiptarët. Gjithsesi shqiptarët kanë bërë më të mirën e mundshme në këtë drejtim.

4. Materiali dhe metoda

Metodologjia e përdorur është studimi dhe interpretimi i fakteve të dhëna në literaturë dhe në burime arkivore. Materialet e shfrytëzuara i kemi parë në një këndvështrim të ri, si zhvillim i së drejtës për edukim të qytetarëve. Të dhënat qoftë nga literatura apo arkivi i përkasin më së shumti Elbasanit, por edhe më gjerë.

5. Rezultatet dhe diskutimet

5.1. Zhvillimi historik i të drejtës për arsim në aspektin ndërkombëtar

E drejta e njeriut për arsimin nuk ka qenë plotësisht e njohur në kontekstin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, deri pas Luftës së Dytë Botërore. Më pas nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara filloi të funksionojë si e tillë. Për të kuptuar përmbajtjen normative bashkëkohore të kësaj të drejte është e domosdoshme që të gjurmohet zhvillimi historik i të drejtës së edukimit dhe objektivat e saj. Përgjatë mesjetës, shteti shumë rrallë luante rol për të inkurajuar hapjen apo për të kontrolluar shkollat.

Vetëm në shek. XVI, shtetet filluan të tregojnë në disa raste interes në edukim dhe kjo për disa arsye: Së pari, të frymëzuar nga autorët klasikë, humanistët mbrojnë idenë që cilësia e jetës mund të përmirësohet, nëse përmirësohet edukimi qytetar dhe moral i njerëzve.

Filozofët e shquar Xhon Loku (1632-1704) dhe Zhan Zhak Ruso (1712-78) në shkrimet e tyre aludojnë drejt koncepteve moderne të të drejtës së njeriut për arsimin. Sipas Lokut në “Traktati i Dytë i Qeverisë” natyra i vesh prindërit me pushtet atëror për të mirën e fëmijëve të tyre gjatë moshës së fëmijërisë, për të kompensuar mungesën e aftësive dhe njohurive të nevojshme nga ana e fëmijëve për të menaxhuar veten dhe të mirat e tyre. Edhe Zhan Zhak Ruso në veprën e tij “Emile” i referohet detyrimit prindëror për të edukuar fëmijët deri sa ata të jenë në gjendje që të përdorin në mënyrë të plotë liritë dhe aftësitë e tyre” Sipas Rusoit “Ne kemi lindur të dobët, ne kemi nevojë për fuqi; të pashpresë, ne kemi nevojë për ndihmë;

të pamend, ne kemi nevojë për arsye. Gjithçka që na mungon në lindje, gjithçka që ne kemi nevojë kur bëhemi njerëz, është dhuratë e edukimit (Mico, 2019, 24). Nën influencën e periudhës së Iluminizmit, ku të drejtat e njeriut po merrnin një perceptim të ri në dritën e parimeve të lirisë dhe barazisë, revolucioni francez dhe ai amerikan kontribuan në formimin e edukimit si një funksion publik (për përfitimin e shumicës së qytetarëve). Rusoi e kupton edukimin racional si një mënyrë riorganizimi shoqëror dhe të së drejtës për arsim në zhvillimin e individit, të botëkuptimit të tij dhe të shoqërisë (Rousseau, 1762).

Parë në këtë kontekst, duhej shteti të merrte përsipër edukimin si të mirë publike. Kështu përgjegjësia për të hapur dhe kontrolluar shkollat binte mbi shtetin. Së dyti, feja dhe edukimi moral synonin të afirmonin autoritetin e mbretit dhe të shtetit. Në luftën kundër herezisë dhe mosmarrëveshjeve politike, sovranët i kthyen sytë nga edukimi. Ata e dinin që mësuesit ishin propaganduesit e ideve të reja dhe “që kur Monarkia u shpall pushtet absolut tregonte interes për metodikën që formonte mendjet dhe zemrat e njerëzve” (Mico, 2019,4). Gjatë shek. XVIII, u rrit ndjeshëm roli i shtetit në drejtimin dhe përmirësimin e shoqërisë. Kjo, pasi individit dhe të drejtat e njeriut filluan të merrnin një konceptim relativisht të ri.

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, e drejta e edukimit gjeti mbështetje në akte të brendshme të shteteve që mbronin të drejtat e njeriut. Shumë shtete filluan të miratonin legjislacionin, nëpërmjet të cilit përcaktohej e detyrueshme pjesëmarrja në shkollë. Këto masa shoqëroheshin me zvogëlimin e numrit të orëve të punës në ditë për fëmijët, me qëllim që të krijohej mundësia, që fëmijët të frekuentonin shkollën. Kushtetuta e Perandorisë Gjermane e 1849 përmbante një seksion të titulluar “Të drejtat themelore të popullit gjerman”, në të cilën kishte të sanksionuar 7 nene (nenet 152-158) lidhur me të drejtën për arsim.

Ishte Kushtetuta gjermane e vitit 1919 ose ndryshe Kushtetuta Gjermane e Vajmarit e cila trajtonte në nenet 142-145 “Arsimimin dhe Shkollimin” duke ia atribuar shtetit si detyrë primare garantimin e arsimimit me anë të shkollimit të detyrueshëm dhe pa pagesë (Mico, 2019, 5).

Megjithatë, është neni 121 i Kushtetutës Sovjetike të vitit 1936 i cili ka të sanksionuar për herë të parë të drejtën për të marrë arsimim kundrejt detyrimit respektiv të shtetit për të siguruar këtë arsimim. Ajo parashikonte arsimim falas dhe të detyrueshëm në të gjitha nivelet, një sistem bursash shteti dhe sistemin e trajnimit profesional në ndërmarrjet shtetërore. Së bashku me të drejtën e punës dhe të drejtën për sigurime shoqërore, e drejta e edukimit ishte e veshur me karakteristikat e të drejtës kushtetuese të shteteve socialiste (Mico, 2019, 5).

Pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1948, Organizata e Kombeve të Bashkuara hartoi dhe miratoi Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në të cilën shpallej dhe pranohej ndërkombëtarisht e drejta për edukim. Fëmijët janë përfituesit kryesorë të kësaj të drejte dhe kryesisht për ta janë ndërtuar sistemet dhe teknikat e edukimit. Megjithatë, neni 26 i Deklaratës

Universale të të Drejtave të Njeriut (Deklarata, 1948) i referohej edukimit të të rriturve duke e konsideruar atë një proces dinamik dhe të vazhdueshëm. Kjo, për vetë arsien e thjeshtë që nuk ka një moment në jetën e njeriut në të cilën edukimi mund të ndalojë, pjesërisht sepse njohuritë nuk mund të qëndrojnë pezull, apo sepse nevojat individuale për ndriçim të mendjes nuk ndalojnë në një moment të caktuar, apo për më shumë, sepse nevoja korrespondon me stimujt që vijnë nga mjedisi që është gjithmonë në ndryshim.

5.2. Arsimi në Shqipëri në vitet 1912-1939

Arsimi para Shpalljes së Pavarësisë karakterizohej nga prania e disa shkollave turke, të cilat në fakt vetëm shkolla nuk ishin. Sipas kujtimeve të Hilmi Daklit²qeveria turke i kishte ndarë shqiptarët më dysh: turq (myslimanët) e kaurrë (të krishterët). Të parët futeshin në “mejtepe”, shkolla gjoja turke, ku mësimi ishte feja: mësohej kurani përmendësh. Të dytët futeshin nëpër shkolla greke të hapura për propagandë.

Shkollat muhamedane ishin shkolla private feje, pa program, të çelura nga ndonjë imam (fetar) mëhalle, që dinte të lexonte vetëm librin e shenjtë, Kuranin, dhe pak, fare pak turqisht. Këto shkolla si lokal kishin në verë sofane e xhamisë dhe në dimër ndërtesën e brendshme të saj. Çdo djalë do t'i paguante hoxhës (mësuesit) një shumë të pacaktuar në krye të çdo muaji (50 santim ar e më poshtë). Në vitin 1890, Abdyl Abdulla Xhinsi, që kishte mbaruar Normalen turke në Stamboll, hapi një shkollë private në Elbasan, në vendlindjen e vet, një shkollë fillore turke, por krejt sipas sistemit të ri që mund të bëhej asokohe në Turqi (Dakli, 2017, 17). Pra, Elbasani dhe shumë qytete të tjera, nuk kishin asnjë shkollë fillore. Kjo do të thotë se qeveria turke nuk e kishte prioritet arsimin dhe nuk e quante si detyrim apo të drejtë të shtetasve të saj. Kjo periudhë, e cila në Shqipëri njihet me emrin “Rilindja Kombëtare”, bëri përpjekje të mëdha për gjuhën dhe shkollën duke i vlerësuar si kusht për ekzistencën e kombit shqiptar. Një nga detyrat kryesore, që u shtrua që në fillim të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, ishte

²Hilmi Dakli, autori i librit “*Ahmed Dakli*”. Ishte i afërm i Ahmed Daklit, gazetarit të guximshëm dhe drejtues i partisë “As i Pashës as i Beut”. Hilmi Dakli ishte diplomuar për jurisprudencë në Itali.

pikërisht ajo e lëvrimit të gjuhës shqipe, e përhapjes së arsimit shqip, e përhapjes së njohurive shkencore dhe të letërsisë së re me përmbajtje patriotike (Myzyri, 1978, 12).

Pas Kushtetutës turke të vitit 1908, populli shqiptar me përpjekje e sakrifica arriti të hapë 70-80 shkolla në gjuhën shqipe dhe një *mësonjëtorë* për mësues në Elbasan (Shaplllo, 1973, 64). Pas Shpalljes së Pavarësisë shteti i sapokrijuar shqiptar u përball me një sërë detyrash të rëndësishme dhe të domosdoshme për t'u kryer. Së pari duhej të siguronte njohjen ndërkombëtare, të vendoste autoritetin në të gjithë teritoret shqiptare, të ngrinte administratën, etj. Në kuadrin prioriteteve një vend të rëndësishëm zuri edhe arsimit. Shpallja e Pavarësisë e gjeti vendin me një numër shumë të kufizuar institucionesh arsimore, ku numëroheshin rreth 250 shkolla fillore dhe disa dhjetëra plotore (Historia, 2007,44). Në qytetet kryesore kishte nga një gjimnaz të vogël. Shkollat shqipe ishin të pakta. Mësimet jepeshin turqisht, greqisht dhe italisht. Shumë prej tyre punonin me programe fetare (Historia, 2007, 44).

Programi i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës parashtronte si qëllim krijimin e sistemit arsimor kombëtar laik, futjen e arsimit fillor të detyrueshëm, përdorimin e detyruar të gjuhës shqipe në shkolla. Edhe përgatitjen e mësuesve përmes shkollave normale dhe kurseve pedagogjike e vlerësonte me përparësi (Rama, 2005, 11).

Në zbatim të kësaj politike, në gusht të vitit 1913, qeveria shqiptare “vendosi që të çilet në çdo sundimtari nga një normale përgatitore ku nxënësit do të pranoheshin mbi bazën e disa kushteve (Rama, 2005, 11). Kushtet caktoheshin në urdhërin e Ministrisë së Arsimit, sipas të cilit, shkolla fillore ishte e detyrueshme për të gjithë nxënësit e Shqipërisë, kurse shkollat e veçanta do të funksiononin vetëm pasi të kishin plotësuar kriteret e përcaktuara në ligj (Përlindja e Shqipëniës, 2013, 2).

Pas ardhjes së Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, në tetor 1913, Qeveria e Përkohshme e Vlorës u ndodh përballë trysnisë për hapjen e shkollave të huaja, në veçanti për rihapjen e shkollave në gjuhën greke për komunitetin ortodoks, të financuara nga Patrikana e Stambollit (Puto, 1987, 614-617).

Kjo tendencë ishte në kundërshtim me masat e marra prej saj, për të vendosur sistemin arsimor në baza kombëtare ku në të gjitha shkollat mësimi do të zhvillohej në gjuhën shqipe. Hapja e shkollave të huaja, ndonëse i shërbente të drejtës për arsimim të shtetasve shqiptarë, nuk plotësonte nevojën e tyre për një arsim në baza kombëtare. Gjatë viteve 1916-1917, vazhduan përpjekjet për hapjen e shkollave, duke filluar nga “Shkolla Popullore”, me

rihapjen e shkollave të huaja etj. Në rregulloren, urdhërat dhe qarkoren që doli nga Drejtoria e Përgjithshme, të cilën duhej ta zbatonin shkollat në Shqipëri midis të tjerave synohej, që të mbështetnin shkollat edhe për ndjekjen e detyrimit shkollor, apo frekuentimin e shkollave nga të gjithë nxënësit (Gjedia, 2013, 32). Në vitet 1916-1917 për arsimin shqiptar hapet një fazë e re. Pushtimi Austro- Hungarez, gjatë Luftës së Parë, krijoi një situatë të re edhe për arsimin. U hapën shkolla në gjuhën shqipe jo vetëm në qytete por edhe në fshatra të Shqipërisë (Gjedia, 2013, 32). Hapja e shkollave në këtë kohë ishte një vlerë e shtuar për arsimin shqiptar.

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, situata e arsimit pati ndryshime të ndjeshme. Mjafton të përmendim këtu mbajtjen e Kongreseve arsimore (1920-1924), të cilët morën vendime të rëndësishme për arsimin në Shqipëri. Këto vendime kishin të bënin me kontrollin e shtetit mbi shkollën dhe strukturën e saj (Musaj, 2002, 106). Forcimi i shkollave ekzistuese do të mbetej në qendër të vëmendjes, por kjo nuk do të thoshte se nuk që të mos i kushtohej vëmendje hapjes së shkollave të reja. Kongresi, me të drejtë, kërkonte këtë zgjidhje paralele (Historia, 2003, 106). U vendos për hapjen e “gjysmëgjimnazeve”, të cilët do të ndiqeshin nga djem që kishin mbaruar shkollat plotore. U caktuan si qytete për “gjysmëgjimnaze”, Berati, Durrësi, Elbasani, por me përparësi dy qytetet e para, pasi Elbasani kishte Normalen (Historia, 2003, 106).

Qeveria e Zogut kur erdhi në pushtet në vitin 1925 trashëgoi një gjendje të rëndë në fushën e arsimit, me shkolla të pakta, me bazë materiale të pakët, me një proces mësimor me plagë të mëdha, që nga periudha e sundimit osman. U shtua numri i shkollave fillore në qytete dhe në fshatra, u krijua fizionomia e arsimit parashkollor, u zhvillua arsimit i mesëm i përgjithshëm dhe profesional. Këto ishin arritje gjithsesi.

Gjatë periudhës 1925-1939, çështja e ruajtjes së frymës kombëtare të shkollës dhe laicizimit të saj, mbeti në rendin e ditës, si një problem i rëndësishëm, në rolin e përgjithshëm të emancipimit të popullit dhe përparimit të atdheut në një vend me tre besime fetare dhe me prani shkollash të huaja. Në vitin 1933 ministri i Arsimit Mirash Ivanaj do të kërkonte reforma radikale që, shkolla të ishte gjithëshqiptare dhe në radhë të parë të e mbi çdo gjë të edukonte atdhetarë... Shteti nuk mund të hiqte dorë nga përgatitja totale, absolute e tërë dhe e pandarë e qytetarëve të ardhshëm. Vetëm me këtë edukim shkollor, sipas Ivanajt, mund të sigurohej e tashmja dhe e ardhmja e vendit (Historia, 2003, 443). Me propozim të tij u ndryshuan nenet 206, 207, të Statutit të Shtetit Shqiptar: Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë, janë një e drejtë ekskluzive e shtetit (Historia, 2003, 443).

5.3. Përmbajtja e legjislacionit arsimor si shprehje e së drejtës për arsimim në vitet 1912-1939

Krahas përpjekjeve për arsimin dhe hapjen e shkollave pas Shpalljes së Pavarësisë, i rëndësishëm është fakti se, tashmë arsimimi po bëhej e një e drejtë për popullin shqiptar. Kjo e drejtë në fakt nuk fillon me Pavarësinë, përkundrazi e gjejmë më herët si kërkesë. Në lidhje me këtë të drejtë Sami Frashëri ka shkruar që në 1899: “Gjithë djemtë e vashatë që më 7 vjeç e gjer më 13 do të jenë të shtrënguarë të venë domosdo në shkollë edhe ata qërtohen e të shtrëngohenë t’i dërgojnë. Mësimi do të jetë pa ndonjë pagesë, edhe të varfëret do t’u epnë fletore, karta etj. pa pagesë” (Frashëri, 1988, 76).

Pas Shpalljes së Pavarësisë, qeveria e Vlorës vendosi që arsimiti fillor të ishte i detyrueshëm për të dy gjinitë, u morën masa për hartimin e programeve dhe teksteve shkollore si dhe u hodhën bazat fillestare të ligjshmërisë arsimore (Historia, 2003, 265).

Në vitin 1914 Statuti Organik i Principatës Shqiptare sanksiononte të drejtën e fëmijëve për t’u arsimuar, pra e vlerësonte si një të drejtë që ju takonte këtyre fëmijëve. Kjo tregon edhe për nivelin e administratës së Princ Vidit. Një administratë e civilizuar që përparimin e vendit e lidhte me shkollimin.

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria rrezikonte të humbte përsëri Pavarësinë. Në vitin 1918 u mbajt Kongresi i Durrësit dhe qeveria e dalë prej tij mori disa masa positive për arsimin. Një nga vendimet e kësaj qeverie ishte që shkolla të ishte 7 vjeçare dhe arsimiti të bëhej i detyruar (Historia, 2003, 363). Ky vendim ishte mjaft i rëndësishëm, pasi shpreh pikërisht një të drejtë të qytetarëve për t’u arsimuar. Gjatë kësaj kohe u rrit ndjeshëm numri i shkollave, i cili arriti në 99 të tilla (Historia, 2003, 366). Kjo tregon edhe një herë se shkollimi po bëhej në një farë mënyre me dëshirë. Zhvillimet e mëvonshme politike bënë të domosdoshme mbajtjen e kongreseve dhe analizën e sistemit arsimor në Shqipëri.

Kongreset arsimore të zhvilluara në vitet 1920-1924, megjithë rëndësinë që patën dhe detyrat e rëndësishme që shtruan, nuk arritën që të realizojnë mbi baza ligjore të drejtën dhe detyrimin për arsimimin e shqiptarëve. Madje edhe qeveria e Nolit, ndonëse pati një program ambicioz për arsimin, nuk arriti të hartonte dhe miratonte ligje në zbatim të programit (Repishti, 1987, 75). Sipas Aurela Anastasit: “Programi i qeverisë të kryesuar nga Fan. S. Noli në vitin 1924 do të parashikonte organizimin e arsimit, mbi baza moderne kombëtare e praktike, në mënyrë që shkollat të formonin qytetarë të vlefshëm, patriotë dhe punëtorë”

(Anastasi, 1999, 84). Kjo do të thotë se akoma nuk ishte situata për ta vlerësuar ligjërisht arsimin si të drejtë dhe detyrim për shqiptarët. E drejta për arsim u bë pjesë e kushtetutës në vitin 1928. Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, e trajtonte atë si një të drejtë themelore të njeriut duke shënuar progres për vetë zhvillimin e kësaj të drejte, por që nuk arriti të legjitimohej plotësisht.

Gjatë periudhës së qeverisjes së Zogut (1925-1939) në aspektin formal legjislativ, dispozitat ligjore edhe në fushën e arsimit, mbulonin në mënyrë të detajuar aspekte të ndryshme të veprimtarisë së shkollës dhe elementëve përbërës të sistemit arsimor.

E drejta për arsim është përfshirë për herë të parë zyrtarisht në ligjin kushtetues të vendit në vitin 1928. Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, e trajtonte atë si një të drejtë themelore të njeriut duke shënuar progres për vetë zhvillimin e kësaj të drejte. Nenet 206 dhe 207 të Statutit sanksiononin të drejtën për arsimin fillor të njohur nga shteti për të gjithë shtetasit, duke e bërë atë të detyrueshëm dhe falas (Omari, Anastasi, 2010, 87-88).

Sipas nenit 206 “Arësimi filluer për gjith shtetasit shqiptar asht i detyrueshëm dhe në shkollat e Shtetit jepet gratis.” Neni 207 përcaktonte se: “Në konformitet me ligjet dhe mbrenda në pryncipet e programeve të pranuëme prej Shtetit për shkollat e veta dhe kurdoherë nën kontrollimin efektiv të Qeverisë, vetëm Shtetasit shqiptarë mund të hapin shkolla të ndryshme private. Të huëjt, në konformitet me ligjët, mund të lejohen vetëm për shkolla teknike e bujqësie me programe teori-praktikë (Luarasi, 1999, 132).

Por duhet thënë se e gjithë kjo nuk kishte të bënte me ndonjë angazhim serioz të qeverive të kohës për të respektuar e për të vënë në jetë të drejtat themelore të shtetasve. Ato ishin formale, në kushtet kur të drejtat politike mund të konsideroheshin mjaft të vakëta, pa realizimin e të cilave nuk mund të flitej për respektim serioz të lirive individuale.

Ligji Organik i vitit 1933 me një amendamet kushtetues i dha shtetit të drejtën ekskluzive për arsimimin e qytetarëve të tij. Qeveria u përpoq të eliminonte propagandën shkombëtarizuese, që ishte e pashmangshme në shkollat e agjencive fetare të huaja dhe përçarëse (Jacques, 1995, 433).

Dy nga klauzolat më të rëndësishme të ligjit të vitit 1933 ishin: Arsim i detyruar, por jo gjithnjë falas dhe jo domosdoshmërisht i detyruar. Nga ky detyrim përjashtoheshin pjesërisht me ligj fëmijët që banonin në zonat rurale të vendit, për shkak të pamundësisë financiare të shtetit për të pajisur me godina shkollore dhe personel të mjaftueshëm mësimor, shkollat në këto zona. Pra edhe ky ligj tregon se arsimimi nuk po bëhej i detyruar dhe e drejtë.

Pavarësisht gjendjes së vështirë ekonomike të vendit, parashikohej edhe mbajtja e shkollave fillore nga ana e popullsisë në rastet kur të ardhurat e bashkive apo komunave ishin të pamjaftueshme. Kështu në këtë mënyrë evidencohej sërish që arsimit fillor, pavarësisht se ishte sanksionuar si një mundësi falas për fëmijët, rëndonte mbi shpatullat e familjarëve që duhej të paguanin për përballuar shpenzimet e domosdoshme të shkollës lidhur me ngrohjen, transformimin dhe meremetimin e ndërtesave shkollore si dhe pajisjen e tyre me mjete didaktike.

Në këtë mënyrë shteti lehtësohej nga ofrimi i kushteve të domosdoshme për të realizuar shkollimin për fëmijët, duke ulur në të njëjtën kohë edhe gjurmimin për frekuentimin e mësimit nga ana e tyre. Nga ana tjetër, fëmijët nuk gëzonin dot mundësinë e frekuentimit të arsimit fillor që ju njihej në ligj. Duke e kushtëzuar detyrimin shkollor me gjendjen dhe cilësinë e ndërtesës, si dhe me stafin e mjaftueshëm arsimor, shteti vetë nuk sanksiononte garanci ligjore e financiare për shtetasit, për ta bërë këtë të drejtë të zbatueshme.

Nga detyrimi shkollor përjashtoheshin gjithashtu:

- a. fëmijët e prindërve e kujdestarëve që nuk kishin banim të qëndrueshëm;
- b. fëmijët e prindërve dhe kujdestarëve që familjarisht jetonin jashtë shtetit;
- c. fëmijët që kishin ndonjë gjymtim fizik e mendor kur në vendbanimin e tyre nuk funksiononin institucione fillore të ngritura për ta, si dhe
- d. fëmijët që vuanin prej ndonjë sëmundje ngjitëse të pashërueshme (Fletore Zyrtare, Nr.54, Tiranë, 28 Shtator 1934. Neni 28).

Nëse analizojmë përmbajtjen vëmë re se, pikërisht kjo përmbajtje e kufizon më së paku të drejtën për arsim dhe më së shumti bën diferencime të pajustificuara midis fëmijëve. Ky ligj përjashton grupe të ndryshme dhe në përfundim na lind e drejta të pohojmë se kjo e drejtë ishte vetëm në letër dhe me pamundësi zbatimi. Shteti duhet t'i mbështeste këto grupe shoqërore, por nuk e bënte. Kjo është ndofta edhe një nga arsytet që arsimit po ecte me ritme të ngadalta. E thënë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ligjet miratoheshin, por zbatimi mbetej i vështirë. Janë një sërë faktorësh që ndikojnë, duke filluar nga ato ekonomike, politike, infrastrukture, kulturore, sociale etj.

Të gjitha këto përjashtime në realitet lidheshin me shtresat në nevojë dhe në vështirësi ekonomike, qasja e të cilëve ndaj të drejtës për arsim mbetej shumë e vështirë.

Jo të gjithë fëmijët trajtoheshin në ligj në mënyrë të barabartë. Nxënësit që jetonin në qytet ishin më të favorizuar në lidhje me përfitimin e mundësisë për edukim sesa fëmijët që jetonin në fshat. Kjo diferencë bëhej e dukshme që në momentin e parashikimit të moshës së

detyrimin shkollor. Në qytet detyrimi shkollor fillonte me shkollat foshnjore prej moshës katër vjeç. Për shkollat e lokalizuara në fshat, detyrimi shkollor ishte vetëm brenda kuadrit të shkollës fillore dhe fillonte nga mosha shtatë vjeç. Kjo qasje vihej re edhe në themelimin e shkollave fillore. Akses jo i barabartë i të drejtës për arsim mes meshkujve dhe femrave. Nisur nga fanatizmi dhe konservatorizmi i theksuar për shkak të veprimit të normave të kanunit, në veçanti në qytetet veriore të Shqipërisë edhe vetë fryma e ligjit bënte dallim mes trajtimit të meshkujve dhe femrave në kuadër të aksesit në arsim. Kështu, neni 68 i “Dekret- ligjës organike të Arsimit” parashikonte që: “Shkollat fillore janë veçan për djelm dhe veçan për vajza. Por kur e kërkon nevoja mund të jenë edhe të përzieme”. Kjo ndarje ndërmjet meshkujve dhe femrave shoqërohej edhe nga personeli mësimor, i cili duhet të ishte në përshtatje me gjininë përkatëse të nxënësve të cilëve do t’u jepte mësim (nenet 69-70 të Dekret- ligjës organike të Arsimit”).

Kësaj panorame i shtohet edhe terreni i thyer dhe mungesa e komunikacionit, të cilat pengonin lëvizjen e banorëve në qendrat urbane si dhe bënë të pamundur lëvizjen e vajzave për në qendrat ku kishte shkolla.

Ligji i vitit 1938 ishte ligji që e vlerësoi si prioritar dhe përgjegjësi të shtetit. Njëkohësisht bëri edhe reformat e mëdha në arsimin shqiptar. Këto reforma e dhanë rezultatin në rritjen e numrit të shkollave, të nxënësve dhe numrit të mësuesve. Përmbajtja e legjislacionit që e konsideron arsimin sit ë drejtë dhe detyrim pati një zhvillim në kontekstin historik. Mbase pak von, por janë kushtet historike që e përcaktuan këtë të drejtë.

5.4. Përfundime

Në përfundim të këtij punimi mund të pohojmë se e drejta për arsimim është shfaqur në historinë e Shqipërisë që në periudhën e Rilindjes Kombëtare.

Pas Shpalljes së Pavarësisë Arsimit dhe e Drejta për arsimim u vu në programin e Qeverisë. Kjo qeveri e vlerësoi si të drejtë legjitime për qytetarët.

Në periudhën e viteve 1912 deri në vitin 1939 legjislacioni shqiptar evoluoi në drejtim të vlerësimit të arsimit si e drejtë dhe detyrim për qytetarët. Ndonëse nuk arriti të realizonte maksimumin e mundshëm, bëri hapa përpara.

Shkolla shqiptare bëri përpara në këtë të drejtë, gjithashtu edhe në masivizimin e saj. Ka rritje të numrit të shkollave, të numrit të nxënësve dhe mësuesve.

Përmbajtja e programeve dhe kurrikulës pati një ndryshim cilësor, që i shërbente kërkesave të zhvillimit të shoqërisë. Me emancipimin e shoqërisë dhe politikës e drejta për arsim bëhet detyrim shpirtëror, krijohet besim dhe shihet si shpëtim.

E drejta për arsim zhvillohet dhe mbrohet nga shteti, por për këtë të drejtë dhe detyrim duhet të perfshihet e gjithë shoqëria. Kombet e arsimuara bëjnë gjithnjë përpara me arsimimin e shoqërisë.

Ndonëse u bënë përpjekje për përmirësimin e legjislacionit, duke pëfshirë të drejtën dhe detyrimin, në fakt asnjëherë nuk u krijuan kushtet për realizimin e kësaj të drejte. Duhet vlerësuar fakti që gjithsesi legjislacioni bëri hapa të rëndësishëm përpara drejt kësaj. Ishte situata e tillë që nuk leonte zbatimin e kësaj të drejte.

Bibliografia

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2007). *Historia e popullit shqiptar III*, Tiranë:

Botimet “Toena”.

Asllani, U. (2000). *Studentët shqiptarë të Austrisë dhe veprimtaria e tyre*, Tiranë: Shtëpia

Botuese “Ilar”.

Dakli, H. (2017). *Ahmed Dakli*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Onufri”.

- Dervishi, K. (2006). *Historia e Shtetit Shqiptar*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Onufri”.
- Dekret-ligja organike e Arsimit”, në: Fletore Zyrtare, Nr. 54, Tiranë, 28 Shtator 1934. Neni 28. Gazeta “Populli”, Vlonë datë 2 maj 1914.
- Frashëri, S. (1988) *Trashëgimi kulturore e popullit Shqiptar*, Botohet nën kujdesin e Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë VolIII, Gazeta “Përlindja e Shqipëriës”, Vit’i I, nr. 1, Vlorë, 24\6 gusht 1913
- Gripshi, G. (2014). *Historia e Peqinit*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Reklama”.
- Grup autorësh. (2003). *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Instituti i Studimeve Pedagogjike, vëll 1, Tiranë.
- Gjedia, R. (2015). *Arsimi në Shqipëri në periudhën 1925-1939*, Tiranë.
- Jacques, E. (1995). *Shqiptarët, Historia e popullit Shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*. Tiranë: Shtëpia Botuese “Kartë e Pendë”.
- Luarasi, A. (1999). Akte juridike Për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, Pjesa II, Shtëpia botuese Luarasi, Tiranë 1999.
- Mico, H. (2019). *Një vështrim i përgjithshëm mbi të drejtën për arsim në Shqipëri* ecuria e kësaj të drejte në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin evropian, Tiranë.
- Musaj, F. (2002). *Gruaja në Shqipëri 1912-1939*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë.
- Myzyri, H. (1978). *Shkollat e para kombëtare Shqiptare*, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”.
- Myzyri, H. (2004). *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: Shtëpia Botuese “alb PAPER”.
- Omari, L.Anastasi, A. (2010). *E drejta kushtetuese*, Tiranë: Shtëpia botuese “ABC”.
- Puto, A. (1987). *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit* (Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik), Vëllimi. II (1912-1918), Tiranë: Shtëpia Botuese: “8 Nëntori”.
- Rama, F. (2005). *Dukuri arsimor gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri*, Tiranë: Shtëpia Botuese: "Argeta- LMG”.
- Repishti, Xh. (1987). *Kongreset arsimore të viteve 1920-1924*, në Studime Historike, viti 1987, Nr.2.
- Shapllo, S. (1973) *Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri*, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”
- Tomasevski, K. (2003). *Education denied. Costs and remedies*, Zed Books LTD

Volio, F. (1979). *The child's right to education: a survey*, In: *The child's right to education*, edited by Gaston Mialaret UNESCO, (Paris: Imprimerie des Presses Universitaires).
WWW.Ideologjia e Jean Jacques Rousseau.